

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Edukimit (Programi Fillor)
Titulli i lëndës:	Matematika 2 për Programin Fillor
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	I (Sem II)
Numri i orëve në javë:	3+2 (5 orë)
Vlera në kredi – ECTS:	6 ECTS
Koha / lokacioni:	10-12.30 E enjte
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof.Asoc. Dr. Ismet Temaj
Detajet kontaktuese:	ismet.temaj@uni-prizren.com
Përshkrimi i lëndës	
	<p>Kursi përmban një rishikim të koncepteve elementare algjebrike, shprehjet algjebrike, ekuacionet lineare, grafikun e ekuacioneve lineare, sistemet e ekuacioneve lineare me dy ndryshore dhe zbatimin e tyre. Po ashtu, në këtë kurs do të shqyrtohen kuptimet themelore nga gjeometria elementare si: trekëndëshi, perimetri dhe sipërfaqja trekëndëshe, katërkëndëshi dhe llojet e katërkëndëshave, rrethi, transformimet izometrike, madhësitë dhe matja e tyre, perimetri dhe syprina e sipërfaqeve shumëkëndëshe, trupat, syprina dhe vëllimi i tyre.</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Qëllimi parësor i kësaj lënde është aftësimi i studentëve për të shqyrtuar disa koncepte themelore nga algjebra. Qëllim i dytë është zgjerimi dhe përgjithësimi i njohurive themelore nga gjeometria. Ndërsa, zhvillimi i aftësive dhe shkathtësive të studentëve për matjen e madhësive dhe zgjidhjen e problemeve të gjeometrisë në rrafsh dhe në hapësirë është gjithashtu një nga qëllimet e rëndësishme të lëndës.</p>
Rezultatet e pritura të nxënies:	<p>Studentët do të jenë në gjendje:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të kryejnë veprimet me shprehjet e

	<p>ndryshme shkronjore.</p> <ul style="list-style-type: none"> • të zgjidhin dhe të diskutojnë zgjidhjet e ekuacionit kuadratik. • të dijen vetitë themelore të funksioneve eksponenciale dhe të vizatojnë grafikun e tyre; • të përshkruajnë ndërtimin e gjeometrisë mbi bazën e sistemit aksiomatik. • të dallojnë figurat gjeometrike në rrafsh, sipas elementeve të tyre. • të analizojnë dhe të konstruktojnë detyra të ndryshme gjeometrike lidhur me trekëndëshin, shumëkëndëshat dhe rrethin. • të identifikojnë vetitë e trupave gjeometrik • të njehsojnë syprinën dhe vëllimin e trupave gjeometrik. • të zgjidhin probleme nga jeta e përditshme. • Kuptimet themelore të vargut
--	---

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxëniet të studentit)

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	-	-	-
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	10	10
Ushtrime në teren	2	15	30
Kollokfiume,seminare	3	2	6
Detyra të shtëpisë	1	15	15
Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	15	15
Përgaditja përfundimtare për provim	2	15	30
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)			
Projektet,prezentimet ,etj	3	2	6
Totali			157 orë

157: 25 6 ECTS.

Metodologjia e mësimdhënies:	Në realizimin e temave mësimore do të shfrytëzohet kjo metodologji e mësimdhënies: leksione të avancuara; diskutime; diskutime; kuize; punë e pavarur; punë në grupe; prezantime.
-------------------------------------	---

Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi mbështetet në këto aktivitete: (Koll.) Testi 1 15 % (Koll.) Testi 2 25 % Provimi përfundimtar 60 % Nota përfundimtare: Pikët (%) Nota 94 -100 10 84 - 93 9 73-83 8 61-72 7 50-60 6
Literatura	
Literatura bazë:	[1] I.Temaj, “ <i>Matematika elementare II</i> ” (Dispensë) Prizren . [2] S.Tahiri, S. Rudi, N. Hyseni (1986) “ <i>Matematika për studentët e grupit klasor</i> ” Prishtinë. [3] R.Zejnullahu, R. Gjergji, F. Berisha, A. Zejnullahu (2003) <i>Matematika 9</i> (Dukagjini) [4] M.Berisha, D. Kamberi, R. Gjergji, R. Zejnullahu (1990) <i>Përmbledhje detyrash nga matematika</i> , Prishtinë [5] Tekste shkollore dhe materiale nga interneti. [6] T. Wesner, H. Nustad, “Algebra with applications (WCB 1991)
Literatura shtesë:	<i>Tekste shkollore (1-9) nga matematika dhe materiale nga interneti.</i>
Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë:	Shprehjet e plota racionale. Polinomi. Veprimet themelor me polinome (mbledhja zbritja dhe shumëzimi). Thjeshtimi i shprehjeve racionale.
Java e dytë:	Ekuacionet kuadratike dhe bikuadratike
Java e tretë:	Paraqitja grafike e funksionit kuadratike , inekuacioni kuadratike
Java e katërt:	Funksioni dhe ekuacioni eksponencial
Java e pestë:	Testi 1
Java e gjashtë:	Kuptimet themelore gjeometrike.
Java e shtatë:	Trekëndëshi. Kongruenca. Perimetri dhe sipërfaqja trekëndëshe
Java e tetë:	Katërkëndëshi dhe llojet e katërkëndëshave.
Java e nëntë:	Rrethi dhe qarku. Pozita e ndërsjellët e dy rathëve.
Java e dhjetë:	Madhësitë dhe matja e tyre. Perimetri i shumëkëndëshave
Java e njëmbëdhjetë:	Syprina e sipërfaqeve shumëkëndëshe

Java e dymbëdhjetë:	Trupat gjeometrikë dhe syprina e tyre.
Java e trembëdhjetë:	Vëllimi i trupave gjeometrikë.
Java e katërbëdhjetë:	Vargjet numerike (aritmetike dhe gjeometrike)
Java e pesëmbëdhjetë:	Testi 2

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
<p>Studentët janë të lirë të bëjnë pyetje dhe të marrin pjesë në çdo aktivitetet.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Gjatë orëve mësimore dhe provimeve nuk lejohet përdorimi i telefonave celularë. - Nuk lejohet ardhja me vonesë apo largimi nga ora pa arsye - Studenti ka të drejtë të merr pjesë në Koll. dhe ne Provim nga lënda, Matematika 2, kur vijueshmëria është së paku 80% nga numri i përgjithshëm i orëve të planifikuara për semestër.